

VENDIM
Nr. 32, datë 3.11.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Altin Binaj,	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 3.11.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, çështjen nr. 4 (E) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Elton Shabani

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1035, datë 21.10.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. 10-2016-806/270, datë 12.4.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2021-1023, datë 16.12.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, pika 1, 29, pikat 2 dhe 3, 34, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “F” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6, pika 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, pikat 1 dhe 2, 71, pika 1, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar pranimin pjesërisht të kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 23.11.2014 ka regjistruar procedimin penal nr. 2897 të vitit 2014 për ngjarjen e vrasjes së shtetasit Xh.O. (ish-F.O.) në datën 22.11.2014, në qytetin e Cërrikut. Në datën 28.11.2014 Drejtoria e Policisë së Qarkut Elbasan, bazuar në urdhrin e prokurorisë, ka ndaluar shtetasin Elton Shabani (*kërkuari*) si të dyshuar për kryerjen e krimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 1476, datë 1.12.2014, ka vendosur të vlefshëm të ligjshëm ndalimin e kërkuarit si person nën hetim, si dhe të caktojë ndaj tij masën e sigurimit personal “arrest në burg”, të parashikuar në nenin 238 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Në përfundim të hetimeve prokuroria ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor

Elbasan kërkesën e datës 24.6.2015 për gjykimin e çështjes penale nr. 2897 të vitit 2014 në ngarkim të kërkuarit.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 1035, datë 22.10.2015, ka vendosur deklarin fajtor të kërkuarit për veprat penale “Vrasja me dashje”, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, në format e mbajtjes pa leje të municioneve luftarake, mbajtjes pa leje të lëndëve plasëse në banesë dhe mbajtjes pa leje të armës në mjedise publike, të parashikuara nga nenet 76, 278, paragrafët 2, 4 dhe 5, të Kodit Penal (KP), duke caktuar dënimin e tij me 30 vjet burgim dhe, në zbatim të nenit 406, pika 1, të KPP-së, dënimin përfundimtar me 20 vjet burgim. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim mbrojtësi i kërkuarit, avokati V.A.

3. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2016-806/270, datë 12.4.2016, ka vendosur: “1. Lënien në fuqi të vendim nr. 1035, datë 22.10.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan në lidhje me deklarin fajtor dhe masën e dënimit për kryerjen e veprave penale parashikuara nga nenet 76, 278§2, 278§4 të K.Penal si dhe për disponimin për vendin e vuajtjes së dënimit, provat materiale dhe shpenzimet procedurale. 2. Ndryshimin e vendimit të sipërcituar si më poshtë: Deklarimin fajtor të të pandehurit Elton Shabanaj për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit”, parashikuar nga neni 278§2 i K.Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Në zbatim të nenit 55 të K.Penal, në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurit me 24 vjet burgim [...]”.

4. Në datën 11.5.2016, mbrojtësi i zgjedhur nga shtetasi M.Sh., babai i kërkuarit, bazuar në nenin 48 të KPP-së, meqë i pandehuri ishte i izoluar në masën e sigurimit “arrest në burg”, avokati V.A., ka paraqitur rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit, bazuar në shkaqet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të nenit 432 të KPP-së. Mbrojtësi ka deklaruar se, për shkak të afatit, në kushtet kur vendimi gjyqësor nuk i ishte vënë në dispozicion, rekursin e plotë do ta paraqiste në një moment tjetër, duke mos i argumentuar shkaqet dhe kërkesat përfundimtare të tij. Po kështu, në datën 13.5.2016 ka paraqitur rekurs edhe avokati A.Ç., edhe ky i zgjedhur nga babai i kërkuarit, në bazë të prokurës së posaçme nr. 832 rep., nr. 314 kol., datë 10.5.2016. Ky rekurs ka të njëjtën përmbajtje me atë të paraqitur nga avokati V.A. Më pas avokati A.Ç. ka paraqitur edhe rekursin me shkaqet e plota. Në datën 13.12.2021 në sekretarinë e Gjykatës së Lartë ka paraqitur parashtrime mbrojtësi i zgjedhur prej vetë kërkuarit, avokati B.D., në bazë të prokurës së posaçme nr. 5986 rep., nr. 4046 kol., datë 26.11.2021.

5. Përpara shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë, neni 278 i KP-së është ndryshuar me ligjet nr. 82/2016, datë 25.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (ligji nr. 82/2016) dhe nr. 44/2019, datë 18.7.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895 datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (ligji nr. 44/2019).

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-1023, datë 16.12.2021, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk plotëson kriteret formale që duhet të përmbajë rekursi.

7. Me kërkesën e datës 19.4.2022, kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) sipas objektit të saj. Me vendimin e datës 26.5.2022, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkuari** ka pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, pasi është cenuar:

8.1 *E drejta e aksesit në gjykatë dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj*, pasi qëndrimi i Gjykatës së Lartë, sipas të cilit rekursi i paraqitur nga avokati V.A. është i paplotë, rekursi i nënshkruar nga avokati A.Ç. është paraqitur nga një subjekt që nuk e kishte tagrin e përfaqësimit, ndërsa parashtrimet e avokatit B.D., përpara shqyrtimit të çështjes në Kolegjin Penal, nuk mund të zëvendësojnë shkaqet e rekursit, i ka cenuar të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, si dhe për t'u dëgjuar nga kjo gjykatë për shkeljet e lejuara nga gjykatat më të ulëta.

8.2 *Parimi i sigurisë juridike, i pritshmërive të ligjshme, i barazisë përpara ligjit, si dhe i gjykatës së caktuar me ligj në drejtim të së drejtës kushtetuese për të përfutur nga ligji penal favorizues, i mosdënimit dy herë për të njëjtën veprë penale (ne bis in idem) dhe i mosdënimit pa ligj*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar ndryshimet që ka pësuar neni 278 i KP-së, çka ka ndikuar në zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Në momentin e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, dispozita në fuqi ka qenë më e favorshme sesa ajo në kohën e gjykimit në gjykatën e apelit. Veç kësaj, Gjykata e Lartë nuk e ka vlerësuar faktin se Gjykata e Apelit Durrës, nisur nga formulimi i pjesës urdhëruese të vendimit të saj, rezulton se e ka dënuar dy herë kërkuesin për veprën penale të parashikuar në nenin 278, paragrafi 2, të KP-së (mbajtja pa leje e municioneve luftarake, pa lejen e organeve kompetente), pasi në fillim e ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për deklarimin e tij fajtor dhe masën e dënimit për këtë veprë penale, ndërsa në një pikë më poshtë e ndryshon atë vendim dhe, po për të njëjtën veprë penale, vendos masën e dënimit me 3 vjet burgim, duke cenuar në këtë mënyrë parimin *ne bis in idem*, pasi ndaj kërkuesit janë vendosur dy dënime kryesore të ndryshme për të njëjtën veprë penale.

8.3 *Standardi i arsytimit të vendimit*, pasi Gjykata e Apelit Durrës në vendimin e saj ka arsyetuar se neni 278, paragrafi 5, i KP-së (mbajtja e armëve në mjedise publike, pa lejen e organeve kompetente) është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 9, datë 26.2.2016. Por, ndonëse kërkuesi është dënuar për këtë veprë nga gjykata e shkallës së parë, gjykata e apelit nuk ka arsyetuar se çfarë ka vendosur në lidhje me këtë dënim, si dhe nuk është shprehur për të as në pjesën urdhëruese të vendimit. Mungesa e arsytimit dhe e disponimit në vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës ka cenuar të drejtën kushtetuese të parashikuar në nenin 142, pika 1, të Kushtetutës, sipas të cilit vendimet e gjykatave duhet të jenë të arsyetuara.

8.4 *E drejta për një proces të drejtë*, pasi Gjykata e Lartë për veprën penale të parashikuar në nenin 248, paragrafi 4, të KP-së duhet të vendoste pafajësinë e kërkuesit, sepse në kohën e gjykimit të çështjes vepra penale nuk ekzistonte, pasi nga tërësia e fakteve, objekti i veprës penale dhe ana objektive e saj nuk provohen. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk ka zbatuar kërkesat ligjore në lidhje me kualifikimin e veprës penale “Vrasja me dashje”, të parashikuar në nenin 76 të KP-së dhe bashkimin e dënimeve sipas nenit 55 të po këtij kodi.

9. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, në parashtrimet e saj drejtuar Gjykatës, ka kërkuar pranimin e pjesshëm të kërkesës, duke argumentuar se:

9.1 Është cenuar *e drejta e aksesit*, sepse në vlerësimin formal të rekursit të paraqitur nga avokati V.A. (vlerësuar si mbrojtës i legjitimuar) është anashkaluar arsyeja e mosparaqitjes së shkaqeve, e lidhur me mungesën e një vendimi të arsyetuar të gjykatës së apelit, ndërkohë që fakti i mungesës së një vendimi të tillë nuk është vënë në dyshim nga Gjykata e Lartë. Mospasja e një vendimi të arsyetuar brenda afatit të rekursit, i ka hequr mundësinë kërkuesit që të parashtrijë në rekurs shkaqet e ankimit. Duke qenë se ai është gjendur në pamundësi për të paraqitur shkaqet e rekursit nëpërmjet mbrojtësit të tij, avokatit V.A., Gjykata e Lartë duhej të kishte marrë parasysh parashtrimet e paraqitura nga mbrojtësi i zgjedhur rishtazi, avokati B.D., ndërsa rekursin e paraqitur nga mbrojtësi tjetër i zgjedhur nga babai i kërkuesit, avokati A.Ç., duhet ta kishte vlerësuar në tërësinë e rrethanave që provonin ekzistencën e një vullneti për të ushtruar rekurs.

9.2 Në lidhje me pretendimet e tjera për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të gjykatës së caktuar me ligj, në drejtim të së drejtës për të përfutur nga zbatimi i ligjit penal favorizues dhe të

parimit të mosdënimit më shumë se një herë për të njëjtën veprë penale, si dhe të parimit të barazisë përpara ligjit, në kushtet e mospranimit të rekursit nga Gjykata e Lartë, pa u shqyrtuar çështja në themel nga kjo gjykatë, kërkuesi nuk legjitimohet, pasi nuk ka shteruar mjetet ligjore. Gjithsesi, në mundësinë e vlerësimit ndryshe nga Gjykata, duhet mbajtur në konsideratë se:

9.2.1 Pretendimi për cenimin e së drejtës së përfitimit nga zbatimi i ligjit penal favorizues është i bazuar, pasi rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan e ka dënuar kërkuesin në vitin 2015 me 6 vjet burgim për veprën penale “mbajtja pa leje e lëndëve plasëse”, të parashikuar në nenin 278, paragrafi 4, të KP-së, ndërkohë që për këtë veprë parashikohej dënimi nga 5 deri në 8 vjet burgim. Ky dënim është lënë në fuqi nga gjykata e apelit në vitin 2016. Gjatë kohës që çështja ishte në shqyrtim në Gjykatën e Lartë, dënimi për këtë veprë penale kishte ndryshuar, duke u bërë nga 1 deri në 4 vjet burgim. Pra, kufijtë e rinj të dënimit penal janë dukshëm më të favorshëm sesa ata të parashikuar në kohën e dënimit të kërkuesit.

9.2.2 Pretendimi i ndalimit të dënimit më shumë se një herë për të njëjtën veprë penale nuk është i bazuar. Rezulton se gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket deklarimit fajtor të kërkuesit dhe dënimin e tij për veprat penale “Vrasja me dashje” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara përkatësisht në nenet 76, 278, paragrafët 2 dhe 4, të KP-së, ndërkohë që ka ndryshuar atë vendim për sa i takon kualifikimit të veprës penale, “Mbajtja pa leje të armëve luftarake”, sipas nenit 278, paragrafi 2, të KP-së, pas ndryshimeve që kishte pësuar KP-ja nga ligjet nr. 144, datë 2.5.2013 dhe nr. 98, datë 31.7.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, si dhe e ka dënuar kërkuesin me 3 vjet burgim. Gjykata e apelit në vendimin e saj ka zbatuar edhe vendimin nr. 9, datë 26.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka shfuqizuar paragrafët 5 dhe 6 të nenit 278 të KP-së dhe në arsyetimin e vendimit nuk konstatohet asnjë kontradiktë me pasojë pavlefshmërinë e vendimit sipas nenit 383 të KPP-së.

9.2.3 Pretendimi për pafajësinë e kërkuesit për veprën penale të parashikuar në nenin 278, paragrafi 4, të KP-së (mbajtja e lëndëve plasëse në banesë, pa lejen e organeve kompetente), i lidhur me kualifikimin e veprës penale “Vrasja me dashje”, të parashikuar në nenin 76 të KP-së dhe bashkimin e dënimeve, sipas nenit 55 të KP-së, nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, pasi lidhet me mënyrën se si janë interpretuar dhe vlerësuar provat nga gjykatat e zakonshme.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2 të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në

procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Për sa i përket *shterimit të mjeteve juridike efektive*, bazuar në parashikimet e nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata konstaton se objekt i këtij ankimi kushtetues individual është vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuari e ka përmbushur këtë kriter, pasi ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

13. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, nga materialet bashkëlidhur kërkesës rezultojnë se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që përmbyll procesin gjyqësor të kundërshtuar nga kërkuari, mban datën 16.12.2021, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 19.4.2022, pra brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 (datat 16, 17 dhe 18 prill 2022 kanë qenë ditë pushimi zyrtare për shkak të Pashkëve Katolike).

14. Për sa i takon legjitimimin *ratione materiae*, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, në lidhje me përmbajtjen e pretendimeve të ngritura në ankimin kushtetues individual, Gjykata thekson se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë.

15. Nisur nga ky këndvështrim, Gjykata vëren se kërkuari, ndër të tjera, ka pretenduar se Gjykata e Lartë në lidhje me veprën penale të parashikuar në nenin 278, paragrafi 4, të KP-së duhet të vendoste pafajësinë e kërkuarit, sepse në kohën e gjyqësorit të çështjes vepra penale nuk ekzistonte, pasi nga tërësia e fakteve, objekti i veprës penale dhe ana objektive e saj nuk provohen. Po kështu, sipas tij, Gjykata e Lartë nuk ka zbatuar kërkesat ligjore për kualifikimin e veprës penale “Vrasja me dashje”, të parashikuar në nenin 76 të KP-së dhe bashkimin e dënimeve sipas nenit 55 të po këtij kodi.

16. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit, janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjyqësorit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2021; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 7, datë 7.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se shqyrtimi i këtij pretendimi të kërkuarit nuk hyn në juridiksionin kushtetues, ndërsa pretendimet e tjera të tij, në lidhje me cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, të parimit të sigurisë juridike, të pritshmërive të ligjshme, të barazisë përpara ligjit, të gjykatës së caktuar me ligj në drejtëm të së drejtës kushtetuese për të përfituar nga ligji penal favorizues, hyjnë në juridiksionin e saj, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës dhe do të analizohen në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë

18. Kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë dhe të marrjes së një përgjigjeje përfundimtare prej saj, pasi qëndrimi i Gjykatës së Lartë se rekursi i paraqitur nga avokati V.A. është i paplotë, rekursi i nënshkruar nga avokati A.Ç. është paraqitur nga një subjekt që nuk e kishte tagrin e përfaqësimit, ndërsa parashtrimet e avokatit B.D. përpara shqyrtimit të çështjes në Kolegjin Penal nuk mund të zëvendësojnë shkaqet e rekursit, i ka cenuar të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, si dhe për t’u dëgjuar nga kjo gjykatë për shkeljet e lejuara nga gjykatat më të ulëta.

19. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka parashtruar se kërkuessit i është cenuar e drejta e aksesit nga Gjykata e Lartë, sepse në vlerësimin formal prej saj të rekursit të paraqitur nga avokati V.A. (vlerësuar si mbrojtës i legjitimuar) është anashkaluar arsyeja e mosparaqitjes së shkaqeve, e lidhur me mungesën e një vendimi të arsyetuar të gjykatës së apelit, ndërkohë që fakti i mungesës së një vendimi të tillë nuk është vënë në dyshim nga Gjykata e Lartë. Mospasja e një vendimi të arsyetuar brenda afatit të rekursit, i ka hequr mundësinë kërkuessit të parashtrojë në rekurs shkaqet e ankimit. Duke qenë se ai është gjendur në pamundësi për të paraqitur shkaqet e rekursit nëpërmjet mbrojtësit të zgjedhur prej tij, avokatit V.A., Gjykata e Lartë duhej të kishte marrë parasysh parashtrimet e paraqitura nga mbrojtësi i zgjedhur rishtazi, avokati B.D., ndërsa rekursin e paraqitur nga mbrojtësi tjetër i zgjedhur nga babai i kërkuessit, avokati A.Ç., duhet ta kishte vlerësuar në tërësinë e rrethanave që provonin ekzistencën e një vullneti për të ushtruar rekurs.

20. Në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e gjykimit të drejtë dhe publik brenda afatit të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimin nr. 10, datë 12.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesin në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Po në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se e drejta e ankimit, ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë, nuk mund t'i cenohen kërkuessit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore (*shih vendimet nr. 5, datë 2.3.2011; nr. 22, datë 26.7.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në vështrim të garantimit të standardit të aksesit në gjykatë, Gjykata ka pohuar se dispozitat e KPP-së nuk mund të interpretohen nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në mënyrë të ngushtë, të atillë që cenon thelbin e së drejtës së një individ për t'iu drejtuar asaj gjykate (*shih vendimin nr. 5, datë 2.3.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Rekursi është akti procedural në të cilin parashtrohen shkaqet për të cilat kundërshtohet një vendim, sipas kërkesave të nenit 432 të KPP-së, që mundëson të drejtën e të pandehurit për të filluar gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe, në këtë kuptim, ai është akti me të cilin garantohet e drejta për akses në atë gjykatë (*shih vendimet nr. 53, datë 5.12.2012; nr. 41, datë 28.9.2011; nr. 38, datë 30.12.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata është shprehur se Gjykata e Lartë i ka të gjitha hapësirat që kërkesat ligjore për elementet formale që duhet të plotësojë rekursi, në përputhje me funksionin e saj të interpretimit të normës dhe në kuptim të parimit të subsidiaritetit e pozicionit të saj në piramidën gjyqësore, t'i interpretojë me qëllim garantimin e të drejtave themelore të individit, konkretisht të së drejtës së aksesit substancial (*shih vendimin nr. 6, datë 22.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) është shprehur se rregullat që dispijlojnë hapat formalë për paraqitjen e një ankimi, synojnë të sigurojnë miradministrimin e drejtësisë. Sipas saj, thelbi i së drejtës së aksesit në gjykatë cenohet kur rregullat procedurale pushojnë së shërbyeri qëllimit të administrimit të duhur të drejtësisë dhe formojnë një lloj pengese për palën ndërgjyqësore që çështja e tij/saj të vendoset në themel nga gjykata kompetente (*shih vendimin në çështjen Zubac kundër Kroacisë [GC], datë 5.4.2018, § 98*). Në veçanti, çështja e administrimit të duhur

të drejtësisë është element kryesor për të bërë dallimin midis formalizmit të tepruar dhe zbatimit të pranueshëm të formaliteteve procedurale (*po aty*, § 98). Në shqyrtimin e proporcionalitetit të kufizimit të aksesit në gjykatë, GJEDNJ-ja merr parasysh gabimet procedurale të kryera gjatë procedurave, të cilat e pengojnë kërkuesin të gëzojë një akses të tillë dhe përcakton nëse kërkuesi ishte detyruar të mbante një barrë të tepruar për shkak të këtyre gabimeve (*po aty*, §§ 90-95, 119). Aty ku janë bërë gabime para gjykatave më të ulëta, GJEDNJ-ja ka vlerësuar rolin e mëvonshëm të Gjykatës së Lartë (*po aty*, §§ 122–124).

24. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se nga dosja gjyqësore e administruar për nevoja të këtij gjykimi kushtetues, në fazën e hetimit penal, babai i kërkuesit ka zgjedhur mbrojtës të kërkuesit avokatin V.A., bazuar në prokurën e posaçme nr. 1469 rep., nr. 557 kol., datë 15.6.2015, e cila është pjesë e fashikullit të akteve që i përkasin dosjes penale. Gjatë procesit gjyqësor në shkallën e parë (në seancën gjyqësore të datës 20.7.2015) avokati V.A. ka marrë përsipër mbrojtjen e kërkuesit. Gjithashtu, kërkuesi, disa herë gjatë gjykimit, me deklaratë, ka bërë të ditur se nuk do të paraqitej në seancë dhe se do të përfaqësohej nga avokati V.A. Ky i fundit rezulton të ketë qenë i pranishëm në gjykimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur ankimin kundër vendimit të saj, si dhe ka marrë pjesë si mbrojtës në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Apelit Durrës.

25. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, në datën 11.5.2016, brenda afatit ligjor, avokati V.A. ka paraqitur rekurs, ku ka shprehur qëndrimin e tij për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të faktit, duke referuar si shkaqe ato të parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të nenit 432 të KPP-së. Ai ka deklaruar se vendimi që kundërshton nuk i është vënë në dispozicion i arsyetuar, prandaj është në pamundësi të evidentojë shkaqet e kundërshtimit dhe kërkimet përfundimtare, por ka vepruar në këtë mënyrë për të mos humbur afatin e rekursit. Po kështu, Gjykata konstaton se nga aktet e dosjes gjyqësore nuk rezulton që avokati V.A. ose vetë kërkuesi të jenë njoftuar për vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Apelit Durrës.

26. Ndërkohë rezulton se në datën 13.5.2016 kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës ka paraqitur rekurs edhe avokati A.Ç., i zgjedhur nga babai i kërkuesit. Ky rekurs ka përmbajtje të njëjtë me atë të paraqitur nga avokati V.A., por është plotësuar me shkaqet e ankimit pas arsyetimit të vendimit të gjykatës së apelit, akt ky që është administruar në dosjen gjyqësore. Tre ditë përpara seancës së caktuar në dhomë këshillimi, në datën 13.12.2021, avokati B.D. i zgjedhur nga kërkuesi, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë parashtrime në vazhdim të rekursit të paraqitur dhe shtesës së rekursit të bërë nga avokati A.Ç.

27. Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka vlerësuar se avokati V.A. legjitimohej në paraqitjen e rekursit, duke çmuar se ai ishte mbrojtës i zgjedhur personalisht prej të pandehurit (i mandatuar me tagra gjatë gjykimit), por duke qenë se rekursi për zënien e afatit rezulton pa pretendime konkrete, në kushtet e inekzistencës së shkaqeve, e ka konsideruar si të vesuar dhe si të tillë të papranueshëm (*shih paragrafët 24–25 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Veprimet e avokatit A.Ç. i ka konsideruar si veprime të kryera pa tagra të deleguara në mënyrë të ligjshme dhe, si të tilla, nuk i ka shqyrtuar, ndërsa parashtrimet e avokatit B.D. nuk i ka marrë në shqyrtim, duke arsyetuar se ato nuk mund të vlerësohen si plotësim i të metave të rekursit të paplotë të paraqitur nga avokati V.A. dhe nuk mund të zëvendësojnë mjetin procedural të ankimit në gjykatën më të lartë, në rastin konkret të rekursit (*shih paragrafët 27, 28 dhe 29 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se rekursi i kërkuesit ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës nuk duhet të merret në shqyrtim, pasi nuk plotëson kriteret formale që duhet të përmbajë. Ndërkohë, ajo nuk shprehet në vendim në lidhje me njoftimin e kërkuesit ose të mbrojtësit të tij për vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Apelit Durrës, ndonëse dosja është dërguar nga gjykata e apelit në gjykatën e shkallës së parë për paraqitjen e rekurseve eventuale në datën 26.5.2016, pra pas kalimit të 30 ditëve nga shpallja e vendimit.

28. Nga rrethanat e mësipërme, Gjykata vlerëson se pavarësisht se rekursi i paraqitur nga mbrojtësi i zgjedhur nga kërkuesi, avokati V.A., është i paplotë, pasi nuk përmban shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit dhe argumentet përkatëse në lidhje me kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, kërkuesi, si nëpërmjet mbrojtësit që kishte mbrojtur interesat e tij deri në gjykatën e apelit (avokatit V.A.), ashtu edhe nëpërmjet avokatëve të tjerë, ka shprehur qartë vullnetin për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta. Nga ana tjetër, fakti që ky mbrojtës nuk ka paraqitur rekurs të plotë për të parashtruar shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së, është kushtëzuar nga mosnjohimi i vendimit të arsyetuar të Gjykatës së Apelit Durrës.

29. Po kështu, Gjykata konstaton se në praktikë ka gjetur zbatim paraqitja e kërkesës “për zënie afati” të ankimit/rekursit, për palën që kërkon të kundërshtojë vendimin gjyqësor, por që për shkak të mosarsyetimit të tij brenda afatit ligjor nuk kishte mundësi të pasqyronte shkaqet ose të ngrinte pretendimet kundër vendimit gjyqësor të kundërshtuar. Kjo praktikë i ka shërbyer aksesit substancial të individit në gjykatë dhe është njohur për të konsideruar të shfaqur vullnetin e individit për të kundërshtuar vendimin brenda afateve ligjore, duke i dhënë mundësinë që pasi të njihej me arsyetimin e vendimit, të plotësonte shkaqet e ankimit.

30. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se të drejtat individuale, qoftë edhe të natyrës procedurale (këto të fundit të konceptuara në funksion dhe të garancive të të drejtave materiale), duhet të interpretohen gjithmonë në atë mënyrë që të jenë efektive (*shih vendimet nr. 6 datë 22.2.2022; nr. 5, datë 2.3.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Prandaj, Gjykata, nisur nga ky standard, çmon se në kushtet kur përfaqësimi me mbrojtës në Gjykatën e Lartë është i detyrueshëm dhe kërkuesi gjendet në kushtet e kufizimit të lirisë personale, ajo duhej ta kishte shqyrtuar në tërësinë e fakteve shkakun e mosparaqitjes së rekursit të plotë kundër vendimit të apelit dhe vullnetin e tij për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kjo e fundit, edhe pse ka legjitimuar mbrojtësin V.A., të zgjedhur fillimisht prej babait të kërkuesit, zgjedhje të cilën edhe vetë kërkuesi e ka konfirmuar, duket se ka mbajtur një qëndrim formalist në vijim, pasi ka vlerësuar se nuk legjitimohet mbrojtësi i dytë i zgjedhur nga babai sërish mbi të njëjtën bazë ligjore (neni 48, pika 3, i KPP-së). Gjykata e Lartë nuk ka shkuar përtej një kontrolli formal të prokurës, në drejtëm të verifikimit nëse edhe zgjedhja e mbrojtësit të dytë nga babai i të gjykuarit ishte rezultat edhe i vullnetit të plotë të këtij të fundit.

32. Në këto rrethana, si dhe në situatën kur mbrojtësi i zgjedhur nga babai (avokati A.Ç.), duke paraqitur rekurs për zënie afati me të njëjtën përmbajtje të rekursit të paraqitur nga mbrojtësi i zgjedhur nga kërkuesi, ka konfirmuar vullnetin e këtij të fundit për kundërshtimin e vendimit, duke paraqitur më pas edhe shkaqet e rekursit, Gjykata e Lartë ka anashkaluar arsyen e mosparaqitjes së shkaqeve, konkretisht mungesën e një vendimi të arsyetuar të gjykatës së apelit, brenda afatit të paraqitjes së rekursit, si dhe vullnetin e kërkuesit, tashmë të manifestuar për kundërshtimin e vendimit dhe ka vendosur *a priori* mospranimin e rekursit për mungesë të kriterëve formale që ai duhet të përmbajë.

33. Sikurse parashtron edhe subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, Gjykata e Lartë duhej të kishte marrë parasysh parashtrimet e paraqitura nga mbrojtësi i zgjedhur rishtazi nga kërkuesi, avokati B.D., ndërsa rekursin e paraqitur nga mbrojtësi tjetër i zgjedhur nga babai i kërkuesit, avokati A.Ç., duhet ta kishte vlerësuar në tërësinë e rrethanave që provonin ekzistencën e një vullneti për të ushtruar rekurs.

34. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë kishte të gjitha hapësirat që kërkesat ligjore për elementet formale që duhet të plotësojë rekursi, në përputhje me funksionin e saj të interpretimit të normës, si dhe në kuptim të parimit të subsidiaritetit e pozicionit të saj në piramidën gjyqësore, t'i interpretonte me qëllim garantimin e të drejtave themelore të individit, konkretisht të së drejtës së

aksesit substancial. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj është i bazuar.

35. Në vijim, Gjykata, duke ritheksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë, e cila i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të kryer një rol që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën (*shih vendimet nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 62, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*), vlerëson të mos ndalet në analizimin e pretendimeve të tjera të kërkuarit, që kanë të bëjnë me cenimin e parimit të sigurisë juridike, të pritshmërive të ligjshme, të barazisë përpara ligjit, të gjykatës së caktuar me ligj në drejtim të së drejtës kushtetuese për të përfutur nga ligji penal favorizues, për sa kohë që çështja do të merret sërish në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit duhet t'u japë atyre përgjigje të arsyetuar.

36. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit është i bazuar dhe duhet të pranohet sipas arsyetimit të mësipërm.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2021-1023, datë 16.12.2021, të Gjykatës së Lartë si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 3.11.2022.

Shpallur më 1.12.2022.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Elsa Toska, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Fiona Papajorgji

Anëtarë kundër: Sonila Bejtja, Altin Binaj, Ilir Toska

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e ankimit kushtetues individual të paraqitur nga kërkuari Elton Shabani, me objekt shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Gjykatës së Apelit Durrës dhe Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën, ne gjyqtarët jemi kundër qëndrimit të shumicës që ka vlerësuar se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit është i bazuar dhe, si i tillë, duhet të pranohet.

2. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tonë kundër.

3. Siç rezulton nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, në fazën e hetimit paraprak kërkuesi i arrestuar është mbrojtur nga avokati D.Ç., i zgjedhur nga vetë ai me deklaram, datë 28.11.2014, përpara organit procedues. Për mbrojtjen e kërkuesit nga ky avokat (në datën 1.12.2014) ka lëshuar prokurë të posaçme edhe babai i tij. Ky avokat e ka mbrojtur kërkuesin deri në përfundim të hetimeve paraprake, ndërsa më 28.5.2014 ka hequr dorë nga mbrojtja. Me prokurën e posaçme të datës 15.6.2015, babai i kërkuesit ka caktuar si mbrojtës të tij avokatët V.A. dhe N.Ll. Më 24.6.2014 prokurori ka dërguar për gjykim procedimin penal kundër kërkuesit.

4. Në gjykimin e çështjes penale kundër kërkuesit, ky i fundit, me deklaram në seancë gjyqësore, ka zgjedhur të mbrohet me avokatin V.A., zgjedhur më parë nga babai i tij me prokurë si më lart. Mbi kërkesën e kërkuesit dhe mbrojtësit të tij, gjykata e shkallës së parë ka vijuar gjykimin sipas procedurës së gjyimit të shkurtuar. Në parashtrimet përfundimtare kërkuesi dhe mbrojtësi i tij kanë kërkuar një cilësim të ndryshëm të veprës penale nga prokurori, si dhe caktimin e një dënimi më të butë nga sa ka kërkuar prokurori. Gjykata e shkallës së parë, me vendimin e saj të datës 22.10.2015, ka pranuar kërkesën e prokurorit, duke deklaruar kërkuesin fajtor sipas akuzës në ngarkim të tij.

5. Duke mos qenë dakord me vendimin e gjykatës së shkallës së parë, kërkuesi, nëpërmjet mbrojtësit të zgjedhur prej tij me deklaram përpara gjykatës, pra avokatit V.A., më 30.10.2015 ka ushtruar të drejtën e apelit. Në aktin e apelit janë ngritur pretendime për zbatimin e gabuar të ligjit lidhur me cilësimin juridik të veprës penale dhe për sa i përket dënimit të caktuar.

6. Në gjykatën e apelit kërkuesi ka shfrytëzuar të drejtën për të mos u paraqitur në gjykim dhe, përmes një deklarate me shkrim përpara autoriteteve të institucionit të paraburgimit, ka kërkuar të mbrohet përsëri nga avokati në fjalë. Ky avokat është legjitimuar nga gjykata e apelit dhe ka realizuar mbrojtjen e kërkuesit edhe në këtë shkallë gjykimi. Më 12.4.2016 gjykata e apelit ka shpallur vendimin e saj në prani të mbrojtësit të kërkuesit.

7. Brenda afatit 30-ditor sipas ligjit të kohës (sipas nenit 435, paragrafi i parë, të KPP-së), më 11.5.2016 kërkuesi, nëpërmjet avokatit V.A., ka paraqitur me anë të shërbimit postar rekurs në Gjykatën e Lartë. Në të parashtrohej se shkaqet për të cilat rekursi ngrihej janë ato sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c” të nenit 432 të KPP-së, por pa treguar pikat e vendimit që kundërshtoheshin, shkaqet konkrete të rekursit dhe çfarë kërkohej nëpërmjet tij, gjë për të cilën ka parashtruar se vendimi i kundërshtuar nuk ishte zbardhur, si rrjedhim nuk ishin njohur me arsyetimin e gjykatës, ndaj rekursi i plotë do të paraqitej në një moment tjetër. Sipas akteve të dosjes gjyqësore një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

8. Më 13.5.2016, nëpërmjet shërbimit postar, për kërkuesin është dorëzuar rekurs në Gjykatën e Lartë edhe nga avokati A.Ç., i caktuar me prokurën e posaçme të datës 10.5.2016 nga babai i tij. Edhe ky rekurs ka të njëjtën përmbajtje me atë të paraqitur nga avokati V.A. Në një datë të papërcaktuar, nga aktet e dosjes gjyqësore, avokati A.Ç. ka depozituar rekursin e plotë, duke evidentuar pikat e vendimit që kundërshtohen dhe shkaqet konkrete të rekursit, konkretisht për zbatimin e gabuar të ligjit penal lidhur me cilësimin juridik të veprës penale dhe për sa i përket dënimit të caktuar nga ana e gjykatave të faktit.

9. Në datën 12.11.2021 Gjykata e Lartë ka shpallur listën e çështjeve penale për shqyrtim në dhomën e këshillimit në datën 16.12.2021.

10. Në datën 13.12.2021 avokati B.D., i caktuar nga kërkuesi me prokurën e posaçme të datës 26.11.2021, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë parashtrime në vazhdim të rekursit dhe shtesës së tij të paraqitura nga avokati A.Ç.

11. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e ankimit të kërkuarit.

12. Kolegji ka vlerësuar se rekursi i nënshkruar nga avokati V.A. është paraqitur brenda afatit dhe nga mbrojtësi i legjitimuar, por nuk është në formën e kërkuar nga ligji (neni 412 i KPP-së), pasi nuk përmban shkaqet konkrete të kundërshtimit të vendimit të gjykatës së apelit.

13. Më tej, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka trajtuar rekursin dhe shtesën e tij të nënshkruara nga avokati A.Ç., duke u ndalur në verifikimin e legjitimitetit të këtij avokati për paraqitjen e rekursit, dhe ka arritur në përfundimin se ky rekurs është bërë nga një mbrojtës i palegjitimuar, në kushtet kur kërkuari nuk i ka dhënë këtij avokati tagra të tilla, referuar për këtë edhe vendimit njëses nr. 1/2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

14. Për sa u përket parashtrimeve të paraqitura nga avokati B.D., Kolegji Penal ka vlerësuar se ato nuk mund të zëvendësojnë mjetin procedural të ankimit në rastin konkret, pra rekursin në Gjykatën e Lartë.

15. Shumica ka arsyetuar: “27. Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se rekursi i kërkuarit ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës nuk duhet të merret në shqyrtim, pasi nuk plotëson kriteret formale që duhet të përmbajë. Ndërkohë, ajo nuk shprehet në vendim në lidhje me njoftimin e kërkuarit ose të mbrojtësit të tij për vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Apelit Durrës, ndonëse dosja është dërguar nga gjykata e apelit në gjykatën e shkallës së parë për paraqitjen e rekurseve eventuale në datën 26.5.2016, pra pas kalimit të 30 ditëve nga shpallja e vendimit. 28. ...Gjykata vlerëson se pavarësisht se rekursi i paraqitur nga ana e mbrojtësit të zgjedhur nga kërkuari, avokati V.A., është i paplotë, pasi nuk përmban shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit dhe argumentet përkatëse në lidhje me kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, kërkuari, si nëpërmjet mbrojtësit që kishte mbrojtur interesat e tij deri në Gjykatën e Apelit (avokati V.A.), ashtu edhe nëpërmjet avokatëve të tjerë, ka shprehur qartë kundërshtimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta. Nga ana tjetër, fakti që ky mbrojtës nuk ka paraqitur rekurs të plotë për të parashtruar shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së, është kushtëzuar nga mosnjoftimi i vendimit të arsyetuar të Gjykatës së Apelit Durrës. 29. ... Gjykata konstaton se në praktikë ka gjetur zbatim paraqitja e kërkesës “për zënie afati” të ankimit/rekursit, për palën që kërkon të kundërshtojë vendimin gjyqësor, por që për shkak të mos arsyetimit të tij brenda afatit ligjor, nuk kishte mundësi të pasqyrore shkaqet apo të ngrinte pretendimet kundër vendimit gjyqësor të kundërshtuar. Kjo praktikë i ka shërbyer aksesit substancial të individit në gjykatë dhe është njohur për të konsideruar të shfaqur vullnetin e individit për të kundërshtuar vendimin brenda afateve ligjore, duke i dhënë mundësinë që pasi të njëjti me arsyetimin e vendimit, të plotësonte shkaqet e ankimit. 30. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se të drejtat individuale, qoftë edhe të natyrës procedurale (këto të fundit të konceptuara në funksion dhe të garancive të të drejtave materiale), duhet të interpretohen gjithmonë në atë mënyrë që të jenë efektive (shih vendimet nr. 6 datë 22.2.2022; nr. 5, datë 2.3.2011, të Gjykatës Kushtetuese). 31. Prandaj, Gjykata, nisur nga ky standard çmon se në kushtet kur përfaqësimi me mbrojtës në Gjykatën e Lartë është i detyrueshëm dhe kërkuari gjendet në kushtet e kufizimit të lirisë personale, ajo duhet të kishte shqyrtuar në tërësinë e fakteve shkakun e mosparaqitjes së shkaqeve të plota të rekursit kundër vendimit të apelit dhe vullnetin e kërkuarit për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kjo e fundit edhe pse ka legjitimuar mbrojtësin V.A., të zgjedhur fillimisht prej babait të kërkuarit, zgjedhje të cilën edhe vetë kërkuari e ka konfirmuar, duket se ka mbajtur një qëndrim formalist në vijim, pasi nuk vlerësuar se legjitimohet mbrojtësi i dytë i zgjedhur nga babai sërisht mbi të njëjtën bazë ligjore (neni 48, pika 3, i KPP-së). Gjykata e Lartë nuk ka shkruar përtej një kontrolli formal të prokurës, në drejtim të verifikimit nëse edhe zgjedhja e mbrojtësit të dytë nga babai i të gjykuarit ishte rezultat edhe i vullnetit të plotë të këtij të fundit. 32. Në këto rrethana, si dhe në situatën kur mbrojtësi i zgjedhur nga babai (avokati A.Ç.) duke paraqitur rekurs për zënie afati me të njëjtën përmbajtje të rekursit të paraqitur nga mbrojtësi i zgjedhur nga kërkuari, ka konfirmuar vullnetin e këtij të fundit për kundërshtimin e vendimit, duke paraqitur edhe më pas shkaqet e rekursit, Gjykata e Lartë ka anashkaluar arsyen mosparaqitjes së shkaqeve, konkretisht mungesën e një vendimi të arsyetuar të gjykatës së apelit, brenda afatit të paraqitjes së rekursit, si dhe vullnetin e kërkuarit, tashmë të manifestuar për kundërshtimin e vendimit dhe ka

vendosur a priori mospranimin e rekursit për mungesë të kriterëve formale që ai duhet të përmbajë. ... 34. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë kishte të gjitha hapësirat që kërkesat ligjore për elementet formale që duhet të plotësojë rekursi, në përputhje me funksionin e saj të interpretimit të normës dhe në kuptim të parimit të subsidiaritetit e pozicionit të saj në piramidën gjyqësore, t'i interpretonte me qëllim garantimin e të drejtave themelore të individit, konkretisht të së drejtës së aksesit substancial. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj është i bazuar.”.

16. Referuar arsyetimit të shumicës, duket që ajo ka arritur në përfundimin për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të kërkuarit bazuar mbi këto argumente:

16.1 Kërkuari, si nëpërmjet mbrojtësit që kishte mbrojtur interesat e tij deri në gjykatën e apelit (avokati V.A.), ashtu edhe nëpërmjet avokatëve të tjerë, ka shprehur qartë kundërshtimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta.

16.2 Fakti që mbrojtësi i kërkuarit deri në gjykatën e apelit nuk ka paraqitur rekurs të plotë për të parashtruar shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së, është kushtëzuar nga mosnjohimi i vendimit të arsyetuar të Gjykatës së Apelit Durrës.

16.3 Në praktikë ka gjetur zbatim paraqitja e kërkesës “për zënie afati” të ankimit/rekursit, për palën që kërkon të kundërshtojë vendimin gjyqësor, e cila, për shkak të mosarsyetimit të tij brenda afatit ligjor, nuk kishte mundësi të pasqyroste shkaqet ose të ngrinte pretendimet kundër vendimit gjyqësor të kundërshtuar. Kjo praktikë i ka shërbyer aksesit substancial të individit në gjykatë dhe është njohur për të konsideruar të shfaqur vullnetin e tij për të kundërshtuar vendimin brenda afateve ligjore, duke i dhënë mundësinë që, pasi të njihej me arsyetimin e vendimit, të plotësonte shkaqet e ankimit;

16.4 Në kushtet kur përfaqësimi me mbrojtës në Gjykatën e Lartë është i detyrueshëm dhe kërkuari gjendet në kushtet e kufizimit të lirisë personale, ajo duhej të kishte shqyrtuar në tërësinë e fakteve shkakun e mosparaqitjes së rekursit të plotë kundër vendimit të apelit dhe vullnetin e kërkuarit për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta.

16.5 Gjykata e Lartë edhe pse ka legjitimuar mbrojtësin V.A., të zgjedhur fillimisht prej babait të kërkuarit, zgjedhje të cilën edhe vetë kërkuari e ka konfirmuar, duket se ka mbajtur një qëndrim formalist në vijim, pasi nuk ka vlerësuar se legjitimohet mbrojtësi i dytë i zgjedhur nga babai i tij sërish mbi të njëjtën bazë ligjore (neni 48, pika 3, i KPP-së), duke mos shkuar përtej një kontrolli formal të prokurës, në drejtim të verifikimit nëse zgjedhja e mbrojtësit të dytë nga babai i të gjykuarit ishte rezultat edhe i vullnetit të plotë të këtij të fundit.

16.6 Në situatën kur mbrojtësi i zgjedhur nga babai (avokati A.Ç.), duke paraqitur rekurs për zënie afati me të njëjtën përmbajtje të rekursit të paraqitur nga mbrojtësi i zgjedhur nga kërkuari, ka konfirmuar vullnetin e këtij të fundit për kundërshtimin e vendimit, duke paraqitur më pas edhe shkaqet e rekursit, Gjykata e Lartë ka anashkaluar arsyen e mosparaqitjes së shkaqeve, konkretisht mungesën e një vendimi të arsyetuar të gjykatës së apelit, brenda afatit të paraqitjes së rekursit, si dhe vullnetin e kërkuarit, tashmë të manifestuar për kundërshtimin e vendimit dhe ka vendosur *a priori* mospranimin e rekursit për mungesë të kriterëve formale që ai duhet të përmbajë.

16.7 Gjykata e Lartë kishte të gjitha hapësirat që kërkesat ligjore për elementet formale që duhet të plotësojë rekursi, në përputhje me funksionin e saj të interpretimit të normës dhe në kuptim të parimit të subsidiaritetit e pozicionit të saj në piramidën gjyqësore, t'i interpretonte me qëllim garantimin e të drejtave themelore të individit, konkretisht të së drejtës së aksesit substancial.

17. Referuar qëndrimin të jurisprudencës kushtetuese (*të cituar edhe nga shumica në vendim*), në vështrim të garantimit të standardit të aksesit në gjykatë, dispozitat e KPP-së nuk mund të interpretohen në mënyrë të ngushtë, të atillë që cenon thelbin e së drejtës së një individi për t'iu drejtuar asaj gjykate. Gjithashtu, Gjykata është shprehur se Gjykata e Lartë ka të gjitha hapësirat që kërkesat ligjore për elementet formale që duhet të plotësojë rekursi, në përputhje me funksionin e saj

të interpretimit të normës dhe në kuptim të parimit të subsidiaritetit e pozicionit të saj në piramidën gjyqësore, t'i interpretojë me qëllim garantimin e të drejtave themelore të individit, konkretisht të së drejtës së aksesit substancial.

18. Në ndryshim nga sa ka konkluduar shumica për cenimin e së drejtës së aksesit, referuar rrethanave të rastit në shqyrtim, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se kërkuesi nuk ka arritur të realizojë të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë, jo për gabime procedurale të kryera gjatë procedurave gjyqësore, por për mungesë kujdesi të treguar nga ai vetë dhe mbrojtësit e tij, në përmbushje të detyrimeve procedurale penale për ushtrimin e së drejtës së rekursit, paraqitjen dhe formën e tij.

19. Për të mbështetur këtë qëndrim, sjellim në vëmendje se legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit (neni 1 i KPP-së), si dhe dispozitat procedurale të caktojnë rregullat edhe për mënyrën e gjykimit të veprave penale, rregulla këto që më së pari janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal (neni 2, paragrafi i parë i KPP-së).

20. Në vijim kemi në vëmendje edhe qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), referuar edhe nga shumica, që është shprehur se rregullat që disiplinojnë hapat formale për paraqitjen e një ankimi, synojnë të sigurojnë miradministrimin e drejtësisë dhe se thelbi i së drejtës së aksesit në gjykatë cenohet kur rregullat procedurale pushojnë së shërbyeri qëllimit të administrimit të duhur të drejtësisë dhe formojnë një lloj pengese që pengon palën ndërgjyqëse që çështja e tij/saj të vendoset në themel nga gjykata kompetente; në veçanti, çështja e administrimit të duhur të drejtësisë është element kryesor për të bërë dallimin midis formalizmit të tepruar dhe zbatimit të pranueshëm të formaliteteve procedurale; në shqyrtimin e proporcionalitetit të një kufizimi të aksesit në gjykatë, merr parasysh gabimet procedurale të kryera gjatë procedurave, të cilat pengojnë kërkuesin të gëzojë një akses të tillë dhe përcakton nëse ai ishte detyruar të mbante një barrë të tepruar për shkak të këtyre gabimeve; aty ku janë bërë gabime para gjykatave më të ulëta, vlerëson rolin e mëvonshëm të Gjykatës së Lartë.

21. Lidhur me rastin konkret, dispozitat procedurale kanë vendosur në mënyrë të qartë rregullat për caktimin dhe zgjedhjen e mbrojtësit (neni 48 i KPP-së), sikundër edhe rregullat për ankimin, përfshirë edhe rekursin në Gjykatën e Lartë, për sa i përket formës (nenet 412 dhe 432 të KPP-së), afatit (neni 435 i KPP-së) dhe paraqitjes së tij (neni 413 i KPP-së). Përmes caktimit edhe të këtyre rregullave, të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha subjektet e procedimit penal, ligjvënësi ka disiplinuar këto aspekte të procesit penal për të siguruar atë çka legjislacioni procedural penal ka për detyrë, pra një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor në funksion të miradministrimit të drejtësisë.

22. Neni 48, paragrafi i tretë, i KPP-së përcakton se zgjedhja e mbrojtësit për personin e ndaluar, të arrestuar ose të dënuar me burgim, derisa ky person nuk e ka bërë vetë zgjedhjen, mund të bëhet nga një i afërm i tij, në format e parashikuara nga paragrafi 2, pra me deklaramë të bërë para organit procedues ose me akt të dhënë mbrojtësit ose të dërguar atij rekomande. Kurse sipas nenit 435, paragrafi i dytë, të KPP-së akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen, me pasojë mospranimi, nga mbrojtësi. Rekursi është akti procedural në të cilin parashtrohen shkaqet për të cilat kundërshtohet një vendim, sipas kërkesave të nenit 432 të KPP-së, që mundëson të drejtën e të gjykuarit për të filluar gjykimin në Gjykatën e Lartë. Gjykata ka vlerësuar se mbrojtja me avokat e të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Lartë është kërkesë e nevojshme në funksion të garantimit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale që është në interes të drejtësisë. Kërkesa për nënshkrimin e rekursit nga mbrojtësi, me pasojë mospranimin e tij, e parashikuar nga neni 435 i KPP-së, ka kuptim, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë të pandehurit për të

ushtruar të drejtat që parashikojnë dispozitat procedurale (*shih vendimet nr. 53, datë 5.12.2012; nr. 41, datë 28.9.2011; nr. 38, datë 30.12.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur për pranimin e mbrojtësit të zgjedhur nga familjarët e të pandehurit vetëm nëse provohet se ata po veprojnë në bazë të porosisë që kanë marrë nga i pandehuri. Pra, lejohet zgjedhja e avokatit nga ana e familjarëve vetëm nëse këta të fundit shprehin vullnetin e të pandehurit për të hequr dorë nga pjesëmarrja në proces dhe jo të investohen me këtë zgjedhje nëse ata nuk kanë kontakte me të pandehurin (*shih vendimet nr. 26, datë 8.5.2012; nr. 45, datë 10.10.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Ky standard është mbajtur në rastin e gjykimit në mungesë, ndërkohë që në rastin kur i pandehuri është i pranishëm në gjykim, siç është edhe rasti konkret, pavarësisht se në kushtet e kufizimit të lirisë, ai duhet të provojë se është vendosur në pamundësi për të shprehur vullnetin e tij nëpërmjet dhënies së tagrave mbrojtësit të zgjedhur nga ai vetë ose edhe të zgjedhur nga familjarët.

24. Neni 111, pika 1, i KPP-së parashikon se i pandehuri i izoluar me masë sigurimi ka të drejtë të paraqesë ankesa, kërkesa dhe deklarata nëpërmjet drejtorit të institucionit, i cili lëshon dokument për marrjen në dorëzim të tyre. Ato regjistrohen në një libër të veçantë, i komunikohen menjëherë organit kompetent dhe kanë efekt njëloj sikur të ishin pranuar drejtpërdrejt nga ai organ. Duke mbajtur në konsideratë pozitën e veçantë të personave të izoluar me masa sigurimi, të cilëve u mungon liria e lëvizjes për të vepruar në të njëjtën mënyrë si individët e tjerë, KPP-ja, me qëllim të garantimit të të drejtave të tyre, ka parashikuar disa rregulla në lidhje me mënyrën e veprimit të autoriteteve shtetërore për lëshimin e akteve (*shih vendimin nr. 6, datë 22.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Për rrjedhojë, pavarësisht se kërkuasi gjendej në kushtet e kufizimit të lirisë personale, ai nuk rezulton të ketë përdorur mjetet që i garanton legjislacioni në fuqi, duke i dhënë mbrojtësit të zgjedhur nga familjarët tagrat për përfaqësimin e tij nëpërmjet paraqitjes së rekursit në Gjykatën e Lartë. Vetë Gjykata ka gjetur shkelje në një rast kur gjykatat nuk kishin verifikuar tagrat e avokatit të dhëna nga kërkuasi me prokurë të posaçme të nënshkruar në prani të punonjësve dhe drejtorit të institucionit ku vuante dënimin penal (*shih vendimin nr. 6, datë 22.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*), por ky rast, në mendimin tonë, është i ndryshëm nga ai në shqyrtim.

26. Referuar rrethanave të rastit konkret, në raport me rregullat procedurale penale, vlerësojmë se nuk qëndrojnë argumentet e parashtruara nga shumica për sa më poshtë parashatrojmë.

27. Konkretisht, referuar ligjit procedural penal, për të vënë në lëvizje një gjykatë më të lartë nuk është e mjaftueshme vetëm shprehja e mosdakordësisë për vendimin e gjykatës më të ulët, por paraqitja e aktit procedural të ankimit, ku përveç shprehjes së mosdakordësisë, është i domosdoshëm edhe tregimi i pikave të vendimit që kundërshtohen, i shkaqeve konkrete të ankimit dhe çfarë kërkohet nëpërmjet tij, mungesa e këtyre elementëve sjell si pasojë papranueshmërinë e tij për shqyrtim.

28. Është përtej përcaktimit të ligjit procedural penal të kohës së paraqitjes së rekursit elementi shtesë i konsideruar nga shumica, ai për afatin e paraqitjes së tij, duke e lidhur me njoftimin e arsyetimit të vendimit të kundërshtuar. Në fakt, sipas këtij ligji, *rekursi duhet të paraqitet me shkrim brenda tridhjetë ditëve nga data që vendimi ka marrë formën e prerë (neni 435, pika 1, i KPP-së)*, pra nga data e shpalljes së vendimit nga gjykata e apelit. Gjithashtu, sipas ligjit procedural të kohës, por edhe atij aktual, bërja e njoftimit të vendimit të gjykatës parashikohet për të pandehurin e deklaruar në mungesë (*neni 386 i KPP-së*), ndërkohë në rastin në shqyrtim rezulton që mungesa e kërkuarit të ketë qenë e vullnetshme dhe ai të jetë përfaqësuar/mbrojtur rregullisht në gjykimin në apel nga mbrojtësi i zgjedhur, i cili ka qenë i pranishëm në shpalljen e vendimit, duke u njoftuar kështu për vendimin. Nga ana tjetër, mungesa e dijenisë për vendimin e gjykatës, referuar ligjit procedural penal të kohës së paraqitjes së rekursit, por edhe atij aktual, është një rrethanë që mund të përbëjë shkak për rivendosjen në afat të ankimit në një gjykatë më të lartë, por jo për të përligjur mangësitë e formës së

tij. Për rrjedhojë, ndryshe nga sa arsyeton shumica, në kuadër të procesit që zhvillohej para saj, Gjykata e Lartë nuk mundej proceduralisht të vinte në diskutim dhe të konkludonte për shkakun e mosparaqitjes së shkaqeve të plota të rekursit nga ana e kërkuarit dhe mbrojtësit të tij. Një gjë e tillë i takon një procesi tjetër gjyqësor, juridiksioni fillestar për të cilin nuk i takon Gjykatës së Lartë. Së fundi, përtej gjithë sa më lart, rekursi i paraqitur nga mbrojtësi i zgjedhur nga kërkuari (avokati V.A.) nuk u plotësua asnjëherë edhe mbas arsyetimit të vendimit nga gjykata e apelit.

29. Në vlerësimin tonë nuk qëndron argumenti i shumicës se Gjykata e Lartë edhe pse ka legjitimuar mbrojtësin V.A., të zgjedhur fillimisht prej babait të kërkuarit, zgjedhje të cilën edhe vetë kërkuari e ka konfirmuar, duket se ka mbajtur një qëndrim formalist në vijim, pasi nuk ka vlerësuar se legjitimohet mbrojtësi i dytë i zgjedhur nga babai sërisht mbi të njëjtën bazë ligjore (neni 48, pika 3, i KPP-së). Ndryshe nga sa arsyeton shumica, zgjedhja e mbrojtësit është një e drejtë personale e personit të proceduar penalisht, zgjedhje e cila manifestohet sipas kërkesave formale të ligjit procedural penal. Në rastin konkret nuk rezulton që kërkuari të ketë zgjedhur si mbrojtës avokatin A.Ç. sipas kërkesave të ligjit. Kërkuari kishte zgjedhur një mbrojtës (avokatin V.A.), ndaj zgjedhja e një mbrojtësi tjetër nga familjarët e tij kapërcen mundësinë që ligji u njeh atyre. Kërkuari, pavarësisht qenies në kushtet e paraburgimit, ka pasur të gjitha mundësitë të ndryshonte mbrojtësin e zgjedhur, qoftë edhe me atë të zgjedhur nga familjarët e tij, sikurse ka vepruar më pas duke zgjedhur avokatin B.D., por një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe as pretendohet të ketë ndodhur për avokatin A.Ç. Ndaj nuk ka sesi të konsiderohet formalist qëndrimi i Gjykatës së Lartë për legjitimimin si mbrojtës të kërkuarit të këtij avokati. Për më tepër, në përputhje me kompetencën e saj kushtetuese, Gjykata e Lartë ka shqyrtuar kuptimin dhe zbatimin e nenit 48 të KPP-së, duke njësuar praktikën gjyqësore përmes vendimit nr.1/2014 të Kolegjeve të Bashkuara, vendim ky i marrë, publikuar dhe zbatuar rregullisht shumë kohë përpara paraqitjes së rekursit nga avokati A.Ç., ndërsa është respektuar edhe në vendimmarrjen e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në rastin në shqyrtim. Vlerësojmë kontradiktor qëndrimin e shumicës kur arsyeton se Gjykata e Lartë nuk ka shkuar përtej një kontrolli formal të prokurës, në drejtim të verifikimit nëse edhe zgjedhja e mbrojtësit të dytë nga babai i të gjykuarit ishte rezultat edhe i vullnetit të plotë të këtij të fundit, ndërkohë që, nga ana tjetër, ka konkluduar për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare për ankimin/rekursin e tij, duke shfuqizuar vendimin e Gjykatës së Lartë dhe dërguar çështjen për rigjykim me detyrë shqyrtimin në themel të rekursit. Pra, praktikisht, shumica ka legjitimuar si mbrojtës të kërkuarit avokatin A.Ç. Për më tepër, shumica ka konsideruar të përmbushura edhe kriteret e tjera formale të pranueshmërisë për shqyrtim të rekursit të paraqitur nga ky avokat, për të cilat Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur qëndrim, ndërkohë që një verifikim i tillë është në kompetencën e kësaj të fundit. Ndaj sa më lart, në vlerësimin tonë qasja e shumicës shkon përtej frymës së dispozitave procedurale që rregullojnë aksesin dhe hapësirën e vlerësimit që bën Gjykata e Lartë. Në këtë rast, jo vetëm nuk është provuar pamundësia absolute e kërkuarit për të ushtruar të drejtat e tij nëpërmjet përfaqësuesit të zgjedhur, por nuk jemi as para rastit të mangësive ose gabimeve në veprimtarinë e organeve gjyqësore, që është vlerësuar nga Gjykata se mund të cenojë të drejtën e aksesit ose ankimit (*shih vendimet nr. 6, datë 22.2.2022; nr. 5, datë 2.3.2011; nr. 22, datë 26.7.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata ka theksuar se aksesin në gjykatë nuk është i kufizuar në qoftë se pala e përfaqësuar nga avokati ka mundësi të ngrejë padi lirisht, të paraqesë argumente në mbështetje të saj, si dhe të apelojë vendimet e dhëna (*shih vendimin nr. 14, datë 3.6.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, e drejta e aksesit në gjykatë, ashtu si edhe të drejtat e tjera, nuk është absolute, pasi nga natyra e saj, kjo e drejtë kërkon rregullim ligjor (*shih vendimin nr. 18, datë 3.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Një aspekt konkret i këtij rregullimi janë edhe rregullat për paraqitjen e ankimit, si në drejtim të formës (përmbajtjes), ashtu dhe afatit. E drejta e ankimit dhe bashkë me të dhe e aksesit në gjykatë, ndryshe

nga sa shumica ka lënë të nënkuptohet, nuk janë të drejta absolute dhe të pakufizueshme. Ato mund të bëhen objekt i kufizimeve nga ligjvënësi, me kusht që të respektohet parimi i proporcionalitetit. Në rastin konkret jemi në kushtet kur rekursi i paraqitur nga mbrojtësi i zgjedhur nga kërkuesi nuk plotëson kriteret ligjore në kuptim të nenit 432 të KPP-së, si dhe përpara një rekursi të paraqitur nga një avokat që në mungesë të zgjedhjes nga kërkuesi, nuk legjitimohet në paraqitjen e tij.

31. Për sa më sipër, në mendimin tonë, kërkuesi ka pasur të gjitha mundësitë për të ushtruar lirisht të drejtën për rekurs në Gjykatën e Lartë, gjë të cilën nuk e ka ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit, ndërkohë që mosushtimi siç duhet i kësaj të drejte nuk ka ardhur nga gabime procedurale të gjykatave gjatë procesit ose për shkak të mënyrës së interpretimit/zbatimit të ligjit prej tyre.

32. Në vlerësim tonë, Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim rekursin e paraqitura kundër vendimit të gjykatës së apelit në emër të kërkuesit dhe në mënyrë të arsyetuar ka dhënë argumente për shkaqet që e kanë çuar në mospranimin e tyre.

33. Si përfundim, vlerësojmë se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit nga Gjykata e Lartë është i pabazuar, ndaj Gjykata duhet të vendoste rrëzimin e tij.

Anëtarë: Ilir Toska, Sonila Bejtja, Altin Binaj